
POSTIM ARKIVOR

Udhëzim nr. 01-49, date 23.05.1985



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I
3840

Sekret
Ekzemplar Nr...11..
2084
30.5.85

DEKLASIFIKUAR
Plotësisht me Vendim
KDZH Nr. 10 Datë 11.1.2022
AUTORITETI PËR INFORMIMIN
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

U D H Ë Z I M
I
MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME
Nr. 01-49, Datë 23.5.1985
PËR
KRITERET E PËRCAKTIMIT DHE PËR ORGANIZIMIN E PUNËS
OPERATIVE NË DREJTIM TË TË ARRATISURVE DHE
BAZAVE E LIDHJEVE TË TYRE TË DYSHIMTA

Me qëllim që të ketë një kuptim të saktë mbi kriteret e përcaktimit të personave të arratisur jashtë shtetit si dhe të zbatohen me rigorozitet parimet e normat e Platformës gjatë organizimit të punës operative për zbulimin, parandalimin dhe goditjen në kohë të veprimtarisë armiqësore, që zhvillohet nga të arratisurit e bazat e lidhjet e tyre të dyshimta,

U D H Ë Z O J :

I. Persona të arratisur të konsiderohen :

1. Shtetasit shqiptarë të larguar nga Atdheu së bashku me klikën antipopullore të Zogut, për shkak të aktivitetit të tyre në dëm të interesave të popullit e të Atdheut dhe, si shërbëtorë besnik të kësaj kliko, të cilët edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare mbetën jashtë Atdheut, si elementë kundërrevolucionarë.

ARSH

SEKSIONI

Udhezime

PERIUDHA

1944 - 1985

Dokumenti normon statusin ligjor të kategorisë së "Të arratisurve", duke përfshirë shtetasit e larguar me klikën zogiste, ata të larguar para datës 29 Nëntor 1944 që bashkëpunuan me okupatorin ose luftuan kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare, si dhe personat e arratisur apo që refuzuan kthimin në Atdhe pas kësaj date, duke përjashtuar nga kjo përgjegjësi fëmijët nën moshën 14 vjeç dhe personat e deklaruar të papërgjegjshëm. Në aspektin administrativ, përcaktohet procedura e hapjes së dosjes operative dhe kartelës "Model 4" brenda 30 ditëve nga vërtetimi i faktit për t'u administruar pranë Kartotekës së Drejtorisë III, duke rregulluar specifikisht dokumentimin e fëmijëve të mitur, bashkëshkorteve të martuara jashtë vendit dhe administrimin e fotografive për nevoja kërkimi. Së fundmi, dokumenti sanksionon masat për kategorizimin e këtyre subjekteve nga organet e sigurimit sipas shkallës së rrezikshmërisë (të trajnuar në shkolla spiunazhi, diversantë aktivë apo me potencial armiqësor) dhe hartimin e planeve operative për kapjen ose asgjësimin e tyre përmes kurtheve të organizuara në terren në rast depërtimi në territorin e vendit


Seksioni 1

Dokumenti ka për objekt përcaktimin e kritereve dhe procedurave për identifikimin, klasifikimin dhe regjistrimin administrativ të personave të përfshirë në kategorinë e të arratisurve, duke saktësuar rrethanat historike dhe ligjore mbi bazën e të cilave individët përfshihen në këtë kategori. Në këtë kuadër, ai përcakton se cilët persona konsiderohen të arratisur, rastet që përfshihen në këtë klasifikim, si dhe përjashtimet përkatëse nga përgjegjësia e parashikuar. Në aspektin administrativ, dokumenti parashikon procedurat për regjistrimin dhe dokumentimin e këtyre subjekteve nëpërmjet hapjes së dosjes operative dhe plotësimit të kartelës përkatëse, "Model 4", brenda një afati 30-ditor nga momenti i vërtetimit të faktit. Dokumentacioni përkatës parashikohet të administrohet pranë Kartotekës së Drejtorisë III, duke përcaktuar gjithashtu mënyrën e dokumentimit të rasteve që përfshijnë fëmijë të mitur, bashkëshorte të martuara jashtë vendit, si dhe administrimin e materialeve fotografike për qëllime identifikimi dhe kërkimi. Gjithashtu, dokumenti përcakton kriteret e klasifikimit dhe vlerësimit të këtyre personave nga organet e sigurimit, duke u mbështetur në të dhënat mbi formimin, veprimtarinë e mëparshme dhe shkallën e rrezikshmërisë së vlerësuar. Në këtë klasifikim përfshihen personat e trajnuar në shkolla spiunazhi, individët e përfshirë në veprimtari diversive, si dhe ata që konsideroheshin me potencial armiqësor. Në vijim, parashikohet hartimi i planeve operative për lokalizimin dhe kapjen e personave që mund të depërtonin në territorin e vendit, duke evidentuar edhe praktikat e përdorura nga strukturat e sigurimit për organizimin e kurtheve në terren dhe masat ekstreme të parashikuara ndaj tyre, përfshirë asgjësimin. Në tërësi, dokumenti paraqet kuadrin normativ dhe procedural mbi bazën e të cilit strukturat e sigurimit të shtetit realizonin identifikimin, regjistrimin, klasifikimin dhe ndjekjen operative të personave të konsideruar si të arratisur, duke pasqyruar njëkohësisht mekanizmat administrativë dhe operacionalë të përdorur për trajtimin e kësaj kategorie gjatë periudhës përkatëse.

MEDIA #1

13.Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-49 datë 23.05.1985 për kriteret e përcatimit dhe për organizimin e punës operative në drejtim të të arratisurve dhe baza e lidhjeve të tyra të dyshimta.

MEDIA FAQE #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I
3840

Sekret
Ekzemplar Nr.1.

2084
30.5.85

DEKLASIFIKUAR
Plotësisht me Vendim
KDZN Nr. 10 Datë 11.2.2021
AUTORITETI PËR INFORMIMIN PËR DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

U D H Ë Z I M
I
MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME
Nr.01-49, Datë 23. 5 .1985

PËR
KRITERET E PËRCAKTIMIT DHE PËR ORGANIZIMIN E PUNËS OPERATIVE NË DREJTIM TË TË ARRATISURVE DHE BAZAVE E LIDHJEVE TË TYRE TË DYSHIMTA

Me qëllim që të ketë një kuptim të saktë mbi kriteret e përcaktimit të personave të arratisur jashtë shtetit si dhe të zbatohen me rigorozitet parimet e normat e Platformës gjatë organizimit të punës operative për zbulimin, parandalimin dhe goditjen në kohë të veprimtarisë armiqësore, që zhvillohet nga të arratisurit e bazat e lidhjet e tyre të dyshimta,


U D H Ë Z O J :

I. Persona të arratisur të konsiderohen :

1. Shtetasit shqiptarë të larguar nga Atdheu së bashku me klikën antipopullore të Zogut, për shkak të aktivitetit të tyre në dëm të interesave të popullit e të Atdheut dhe, si shërbëtorë besnik të kësaj klike, të oilët edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare mbetën jashtë Atdheut, si elementë kundërrevolucionarë.

13.Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-49 datë 23.05.1985 për kriteret e përcatimit dhe për organizimin e punës operative në drejtim të të arratisurve dhe baza e lidhjeve të tyra të dyshimta.

MEDIA FAQE #2



2.

2. Shtetasit shqiptarë të larguar nga Atdheu para datës 29 Nëntor 1944 për shkak të aktivitetit të tyre kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare, duke marrë pjesë në organizatat tradhëtare të Ballit Kombëtar e Legalitetit apo të grupeve të tjera që kanë bashkëpunuar me okupatorët, që kanë marrë pjesë në aparatin shtetëror të okupatorit, të Qeverisë Kuislinge, ose që kanë luftuar në formacionet ndryshme Luftën Nacionalçlirimtare.

3. Shtetasit shqiptarë të arratisur nga Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë mbas datës 29 Nëntor 1944, si dhe ata që pas kësaj kohe janë dërguar jashtë shtetit me shërbim ose arsye të tjera dhe kanë refuzuar të kthehen në Atdhe.


4. Nuk konsiderohen të arratisur personat që në kohën e kryerjes së kësaj vepre nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç (mosha për përgjegjësinë penale) si dhe ata të deklaruar të papërgjegjshëm.

II. Procedura që ndiqet për përcaktimin e personave të arratisur.

5. Që të përcaktohen sa më drejt personat që do të konsiderohen të arratisur, organet e Sigurimit të Shtetit grumbullojnë të dhëna nga burime të ndryshme. Të dhënat që shërbejnë si bazë për përcaktimin e të arratisurve jashtë shtetit janë : Listat e personave të arratisur që nuk përfitojnë nga amnistia e shpallur me Dekretin e Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr.3005, datë 23.3.1959, vendimet e komisioneve të posaçme të ngarkuar për hetimin dhe zbulimin e personave të arratisur politik të shpallur në gazetat zyrtare të viteve 1944-1946 për efekt të konfiskimit të pasurive të tyre, dokumentet e Arkivit të Shtetit dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, listat e të arratisurve dhe materiale të tjera operative që

13.Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-49 datë 23.05.1985 për kriteret e përcatimit dhe për organizimin e punës operative në drejtim të të arratisurve dhe baza e lidhjeve të tyra të dyshimta.

MEDIA FAQE #3



3.

disponohen nga vetë degët e punëve të brendshme, të dhënat e Drejtorisë III, dosjet hetimore, dosjet e fashikujt e kërkimit dhe dokumente të tjera që vërtetojnë arratisjen e personave jashtë shtetit.


6. Materialet e mësipërme i nënshtrohen një analize të hollësishme nga punëtorët operativ, shefat e seksioneve të zonave dhe drejtuesit e degës dhe kur nga këto materiale provohet arratisja jashtë shtetit, personi konsiderohet i arratisur.

Në raste të veçanta, kur rrethanat e largimit jashtë Atdheut të një personi nuk dalin të qarta,përcaktimi në se duhet të konsiderohet ose jo i arratisur bëhet me vendime të veçanta nga komisionet e krijuara pranë degëve të punëve të brendshme të rretheve, në përbërje të të cilëve marrin pjesë kryetari i degës së punëve të brendshme, zëvendëskryetari, shefi i seksionit të përgjithshëm, shefi i seksionit dhe punëtori operativ i zonës. Vendimi i komisionit të rrethit, i dërgohet Drejtorisë I (Degës I) të Sigurimit të Shtetit, e cila pasi e diskuton problemin me Drejtorinë III, konkludojnë së bashku në se do të konsiderohet ose jo i arratisur, dhe mbi këtë bazë nga Drejtoria I dhe III përpilohet vendimi përkatës, i cili i paraqitet për miratim ministrit të Punëve të Brendshme. Mbi bazën e vendimit të miratuar bëhen ndryshimet përkatëse në kartotekën e Drejtorisë III e në atë të Degës V dhe njoftohet dega e punëve të brendshme e rrethit përkatës, e cila vë në dijeni komitetin e Partisë së rrethit.

7. Për çdo person të arratisur jashtë shtetit, hapet dosja e të arratisurit në përputhje me kërkesat e rregullores së evidencës operative, e cila 30 ditë pas vërtetimit të arratisjes, i dërgohet nëpërmjet Degës I të Drejtorisë I kartotekës së Drejtorisë III.

13.Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-49 datë 23.05.1985 për kriteret e përcatimit dhe për organizimin e punës operative në drejtim të të arratisurve dhe baza e lidhjeve të tyra të dyshimta.

MEDIA FAQE #4



8.

a. Të aktivizohet agjentura ekzistuese në drejtim të bazave e lidhjeve të dyshimta të të arratisurve, sidomos agjentura që rrjedh nga lidhjet e bazat e tyre.

b. Të studiohen për tërheqjen në bashkëpunim, në përputhje me të dhënat që disponohen për të arratisurit e bazat e tyre, kandidaturat e përshtatshme, me qëllim që nëpërmjet përpunimit e kontrollit të bazave e lidhjeve të arrijmë në kapjen ose asgjesimin e diversantëve.

c. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet tërheqjes së agjenturës me material shtrënguese nga radhët e përpunimeve që ndiqen si agjent të zbulimeve të huaja, sidomos ata që i mbajnë lidhjet me këto zbulime nëpërmjet të arratisurve, pasi ngritja e kësaj agjenture është një nga rrugët më efektive për kapjen ose asgjesimin e bandave diversante që futen ilegalisht në vendin tonë.


ç. Të vihen nën kontroll banesat e lëvizjet e bazave dhe lidhjeve të dyshimta të të arratisurve, duke aktivizuar agjenturën, si dhe persona patriotë me garanci të nevojshme moralo-politike.

d. Për kapjen ose asgjesimin e të arratisurve që futen në vendin tonë ilegalisht nëpërmjet kufirit, ose nëpërmjet rrugëve legale (me dokumenta falso) të zbatohen të gjitha masat që përcaktohen në udhëzimin e ministrit "Për organizimin e kërkimit të agjentëve të zbulimeve të huaja që futen ilegalisht ose me dokumenta falso në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë".

dh. Për organizimin e masave operative e ushtarake, sektori i sigurimit bashkëpunon e bashkërendon veprimet me të gjithë sektorët e tjerë të degës si dhe me Sigurimin e Ushtrisë. Rëndësi e veçantë t'i jepet bashkëpunimit me komandat e reparteve dhe nënreparteve të kufirit për vlerësimin e të dhënave, gjurmëve e sinjalëve në

13.Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-49 datë 23.05.1985 për kriteret e përcatimit dhe për organizimin e punës operative në drejtim të të arratisurve dhe baza e lidhjeve të tyra të dyshimta.

MEDIA FAQE #5



9.

kufi dhe për marrjen e masave të plota e të gjithanshme për kapjen ose asgjesimin e diversantëve që futen ilegalisht ose me dokumenta falso.

e. Për të grumbulluar të dhëna rreth qëndrimit e veprimtarisë të të arratisurve jashtë shtetit, degët e punëve të brendshme, mbi bazën e studimit të bërë, bëjnë propozime për dërgimin e agjenturës jashtë shtetit nëpërmjet rrugës së vizitorëve. Këto propozime analizohen e vlerësohen nga Drejtoria I në bashkëveprim e bashkëpunim me Drejtorinë III dhe kur shihet e nevojshme i paraqiten për miratim Drejtorit të Drejtorisë I.


ë. Me qëllim që të njihet situata rreth qëndrimit e veprimtarisë së të arratisurve jashtë shtetit, degët e punëve të brendshme të bëjnë kujdes që të grumbullojnë informacion nëpërmjet përpunimit e kontrollit të shtetasve të huaj me qëndrim të përkohshëm, nëpërmjet bashkëbisedimeve me të riatdhesuarit; nëpërmjet filtrimit të shkelsave të kufirit; nëpërmjet bashkëbisedimeve me ata vizitorë të ardhur nga jashtë, kur nga masat e marra karakterizohen me qëndrim pozitiv, si dhe nëpërmjet kontaktove e bisedave me shtetasit tanë që shkojnë jashtë shtetit, me shërbim ose për nevoja vetiake.

f. Për verifikimin e ndjekjen e të dhënave për të arratisurit, bazat e lidhjet e tyre, Drejtoria I dhe ajo e III, të bashkërendojnë punën midis tyre në dinamikë.

lë. Për zbatimin e detyrave të shtruara në planet e masave për organizimin e kurtheve operative, punëtorët operativë të zonave punojnë në dinamikë dhe herë pas here bëjnë rifreskimin e tyre me detyra e masa të reja në përputhje me situatat operative. Drejtuesit e degëve dhe shefat e seksioneve ndihmojnë e kontrollojnë për zbatimin e detyrave të shtruara në këto plane, duke bërë edhe analiza periodike.

13.Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-49 datë 23.05.1985 për kriteret e përcatimit dhe për organizimin e punës operative në drejtim të të arratisurve dhe baza e lidhjeve të tyra të dyshimta.

MEDIA FAQE #6



10.

14. Të dhënat që u dërgohen degëve të punëve të brendshme të rretheve nga burimet e Drejtorisë III, analizohen e vlerësohen menjëherë nga degët e punëve të brendshme të rretheve dhe mbi këtë bazë të përcaktohen e merren masat e plota për ndjekjen e tyre. Këto të dhëna, pasi pasqyrohen në relacionet përkatëse të të arratisurve vendosen në dosjen e drejtimit për zbulimin përkatës.

Të dhënat që u dalin vetë degëve të punëve të brendshme të rretheve nga burime të ndryshme, pasi vlerësohen e merren masat për ndjekjen e tyre dhe pasqyrohen në relacionet e të arratisurve sipas përkatësisë, një kopje e tyre, nëpërmjet Degës I të Drejtorisë I i dërgohet kartotekës së Drejtorisë III për t'i vendosur në dosjen e të arratisurve.

15. Me këtë udhëzim të njihen të gjithë punëtorët operativë të sigurimit e të policisë.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi, ngarkohen Drejtoria I dhe Drejtoria III e Sigurimit të Shtetit.

17. Udhëzimi i ministrit, nr.01-132, datë 5.12.1984, shfuqizohet.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
HEKURAN ISAI

13.Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-49 datë 23.05.1985 për kriteret e përcatimit dhe për organizimin e punës operative në drejtim të të arratisurve dhe baza e lidhjeve të tyra të dyshimta.

INFORMACION

13.Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 01-49 datë 23.05.1985 për kriteret e përcatimit dhe për organizimin e punës operative në drejtim të të arratisurve dhe baza e lidhjeve të tyra të dyshimta.

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.